

Çështja e privatësisë —Ç'do të bëje *ti*?



KOHA PËR VETEN

HISTORI E VËRTETË

«Ndonjëherë thjesht dua të jem vetëm dhe të bëj gjërat e mia. Mirëpo, motrat e mëdha më trajtojnë si kalama dhe duan të dinë gjithçka. S'dua t'u fsheh ndonjë gjë, thjesht nuk kam dëshirë t'u tregoj.»
—Alisona.



Pse mendon se motrat e Alisonës priren ta trajtojnë si fëmijë?

Ç'mund të bëjë Alisona që motrat ta kuptojnë se i pëlqen privatësia?

Ç'do të bëje *ti* po të ishe në situatën e Alisonës?



DHOMA JOTE

HISTORI E VËRTETË


«Kur kaloj një ditë të keqe, thjesht dua të rri vetëm. S’diskutohet, është bukur të kesh prindër që kujdesen, por me raste hyjnë pa leje në dhomën time pikërisht kur kam nevojë për pak hapësirë.»

—Rajani.

A mendon se prindërit e Rajanit merakosen për të?

Nëse po, çfarë bën (ose nuk bën) Rajani që ua shton ankthin prindërve?

Ç’do të bëje *ti* që të fitoje besimin e prindërve po të ishe në situatën e Rajanit?



CELULARI YT

HISTORI E VËRTETË

«Mami m'i lexonte mesazhet kurdo që shihte celularin vërdallë. Madje, një herë i bëri *block* një shoku për të cilin mendonte se nuk ndikonte për mirë tek unë.»
—Nadina.

A mendon se mamaja e Nadinës merakoset për të?

Nëse po, çfarë bën (ose nuk bën) Nadina që ia shton ankthin mamasë?

Ç'do të bëje *ti* që të fitoje besimin e mamasë po të ishe në situatën e Nadinës?
